



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave - Sektori i Emergjencave

07.Nr.104/02 - 15725 /24

Kaçanik, 08.07.2024

Mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr.04/L- 027, neni 7,37, dhe 69, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr.04/L-012, neni 5,8,20, dhe 23, Ligjin për Zjarrfikje dhe Shpëtim Nr. 04/L-049, neni, 14 dhe 23 me qëllim të mbrojtjes së jetës së njerëzve dhe kafshëve, ruajtjes e të mirave materiale dhe të mjedisit,

NJOFTIM

Njoftojmë qytetarët e Komunës së Kaçanikut se për shkak të temperaturave të larta dhe rrezikut të ndezjes dhe përhapjes së zjarreve, rreptësisht është e ndaluar, ndezja e hamulloreve, zjarreve të hapura në fusha, male dhe hapësira tjera publike.

Zjarret e hapura janë shkaktar i rrezikut të përgjithshëm, dhe paraqesin vepër të rëndë kundër sigurisë së përgjithshme.

Çdo person i cili vëren rrezikun nga zjarri është i obliguar të informoj Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policinë e Kosovës, ose Qendrën Operative të Alarmimit dhe Informimit Emergjent.

Andaj, lusim qytetarët e komunës sonë ta respektojnë dhe ta përfillin këtë njoftim si dhe të ndikojnë në parandalimin e shkaktimit të zjarreve të hapura.

TELEFONAT PËR NJOFTIM NË RAST ZJARRI

QENDRA E ALARMIMIT,
STACIONI I ZJARRFIKJES -KAÇANIK,
POLICIA E KOSOVËS

TeL - 112
TeL - 044-228-228
Tel. - 192

